



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-06/01-13928/21 datë: 18.06.2021



Npi – 01/187 datë: 23.06.2021

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 23.06.2021, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -VI- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

E mbajtur më: 23.06.2021 (e mërkurë) në ora 14.00 h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit për Komunitete, Kryesuesi: z.Rahman Kadrija, dhe anëtarëve: znj.Fatmire Ferati, znj.Diarta Vishesella, z.Muhamet Ademaj, z.Ruzhdi Brahimi, znj.Xhevahire Ramadani, dhe z.Arton Demiri, kanë marrë pjesë edhe: Nga OSBE-ja z.Muharrem Haziri; Nga Zyra për Komunitete dhe Kthim, shefi i zyrës z.Ibrahim Demiri; Praktikantja znj.Yllka Dashi. Mbledhjen e hapi Kryesuesi z.Rahman Kadrija i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje, mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore 2022-2024 – Shqyrtimi i mundësisë për ndarje të, buxhetit për lëndë djegëse për familjet në nevojë të komunitetit pakicë.
2. Informatë nga DKA-ja për rexhistrimin e fëmijëve të komunitetit pakicë në shkollën fillore dhe të mesme,
3. Informatë nga ZKKK për aktivitetet mujore,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi, z.Rahman Kadrija; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

*** Komiteti për Komunitete, unanimisht aprovoi Rendin e Ditës.**

Pika I

Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore 2022-2024 – Shqyrtimi i mundësisë për ndarje të, buxhetit për lëndë djegëse për familjet në nevojë të komunitetit pakicë

Kryesuesi, z.Rahman Kadrija; Fjalën ja dha Ibrahim Demirit.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Sa i përket KAB-it që lidhet me procesin e diskutimit publik pjesëmarrja ka qenë shumë e ulët. Ne si KPK-ë mundë të bëjmë ndonjë kërkesë për ta futur në dokumentin e KAB-it, mirëpo ka qenë praktikë e mëparshme që nëpër vendbanime janë caktuar prioritetet e atijë lokaliteti, tani nuk ka të interesuar për takime publike për ti adresuar këto nevoja. KAB-i ende mundë të plotësohet me ndonjë projekt. Ne ende sot prioritet e kemi ndërtimin e kanalizimit dhe furnizimin me ujë për pije. Ju si Komitet mundë të keni ndonjë

kërkesë për ndonjë projekt tjetër, mirëpo ne si zyre kemi bërë kërkesën për sa i përket participimit për kompletimin e këtyre 6 shtëpive të komunitetit pakicë. Komiteti gati çdo herë po kërkon rritjen e subvencioneve për ZKKK-në, mirëpo unë nuk e di nëse ka mundësi ose jo.

z.Muharrem Haziri - OSBE; Përshëndetje, unë deshta vetëm të bëjë një sçarim që kërkesat e qytetarëve duhet të bëhen në formën e shkruar me datën me orën dhe me prioritetet, e cila duhet të adresohet në zyrën kompetente. Në të kundërtën fjalët mbetën vetëm fjalë.

znj.Fatmire Ferati; Përshëndetje, pajtohem me Muharremin për pjesën e kërkesave dhe debatit publik. Ne kemi pasë rreth 25 qytetarë sportist por nuk mjafton, ndoshta ende nuk është gjetë forma e ngritjes të vetëdijës së qytetarëve.

z.Muhamet Ademaj; Përshëndetje, unë i dëgjova me kujdes të gjithë që diskutuan lidhur me organizmin e debatit publik. Unë mendoj se te ne ka humbur interesimi i qytetarëve për të marr pjesë në debate publike. Në këtë kuptim unë mendoj se rol kryesorë ka kryetari i fshatit ose bashkësisë.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Konstatojë kuorumin prej 6 anëtarëve prezentë në mbledhje.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht i rekomandon, Kuvendit të Komunës së Shtimes aprovimin e Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore për periudhën 2022-2024, me kërkesën që të shtohen Subvencionet për Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim edhe për 2000€.**

Pika 2

Informatë nga DKA-ja për rexhistrimin e fëmijëve të komunitetit pakicë në shkollën fillore dhe të mesme

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Fjalën ja dha Agime Roshaj.

znj.Agime Roshaj, drejtoreshë e DKA; Përshëndetje, për sa i përket shkollave të mesme ende nuk ka filluar regjistrimi i nxënësve për këtë arsye deri tani nuk kemi të dhëna të sakta. Në shkollën fillore "Emin Duraku" në Shtime, nga komuniteti pakicë janë gjithësej 6 nxënës. Te shkolla fillore "Lasgush Poradeci" në paralelen e ndarë ne Gjyrkovcë janë 5 nxënës parashkollorë, 6 në klasën e parë. (Të dhënat tjera nuk kamë arrit me i marrë).

z.Arton Demiri; Kamë një pyetje për drejtoreshën, meqenëse janë ndarë disa IPOD nga Komuna a keni një listë se kujt i janë dhënë këta IPOD?

z.Muhamet Ademaj; Nga DKA-ja ende nuk kanë filluar me rexhistrim në shkollën e mesme. Te shkolla e mesme profesionale ende ka vende të lira për nxënës dhe po shpresojmë se do të vijnë e të regjistrohen nxënës me nota më të mira edhe në shkollën profesionale e jo vetëm ne gjimnaz.

znj.Agime Roshaj, drejtoreshë e DKA; Ka pasë një komision që është marrë me këtë qështjen e ndarjes së IPHOD-ave, tani unë mundem me marrë informata të sakta nga komisioni për ndarjen e këtyre paisjeve, mirëpo tani për tani nuk e di saktësisht. Mundem me ju informuar se komunitetet në Komunën tonë janë shumë mirë të integruar, po ashtu mundë të ju them se ndarja e këtyre paisjeve nuk janë bërë mbi baza të përkatësisë etnike.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Komuniteti Romë i ka gjithësej 5 nxënës në shkolla. Një llaptopë të ri e ka marrë djali i Bajrushit.

Pika 3

Informatë nga ZKKK për aktivitetet mujore

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Fjalën ja dha Ibrahim Demirit.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Unë po e përmendi një kërkesë e cila është aprovuar nga IOM-i ku është planifikuar që 70% do ti mbulojë IOM-i ndërsa 30% Komuna, për ndërtimin e kanalizimit prej 460m. në rrugën "Sami Frashëri" në Shtime, e cila është planifikuar të kushtojë 10000 euro. Së shpejti pritët edhe nënshkrimi i marrëveshjes me Kryetarin ne shumë prej 4000 euro ose 30%. IOM-i ka aprovuar edhe 2 projekte të tjera individuale, njëri te Driton Demiri dhe

tjetri te Arsim Jakupi te të cilët është paraparë që edhe këta të participojnë me 10% në shumën e pergjithëshme deri 4000 euro. Paisje për saldim i kemi 10 kërkesa në zyren tonë të cilat do ti procedojmë tutje. Kërkesat për ndihma kanë të bëjnë me strehimin-banimin, qiranë, mjekim etj. Të alokuara i kemi 2000 euro e që nënkupton se mundë ti realizojmë vetëm 9 kërkesa.

z.Ruzhdi Brahimi; Përshëndetje, u tha se ka kërkesa për aparate salduese, pyetja ime është këta parashtues të kërkesave a kanë diploma? Unë mendojë se këta janë simpatizuesit partiak të juaj, pikërisht të Ibrahim Demirit dhe Rrahman Kadriut, ju mbi bazën e ketyre kriterëve partiake po i ndani edhe projektet.

Pika 4

Të ndryshme

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Arton Demiri; Sa i përket Driton Demirit unë e kam vëlla, ata kanë ardhë dhe e kanë gjetë vëllaun duke salduar dyer, dhe e kanë pyet, a e pranon një projekt ku mundë të ju ndihmojmë me paisje ai ka thënë po, po ashtu kisha pranuar që me mu ndalu ndihma sociale.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija mbledhjen e përfundoi në ora 15.20 h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Rrahman Kadrija